



## Republika e Kosovës



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 95 Nr. ifaq/Br.sfr./No pg 01/23

Data/Datum/Date 27.06.2023

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 27.06.2023 miraton këtë:

### V E N D I M

#### Shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510056-00050-0 në Zonën Kadastrale Optrushë

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/727/23 i datës 8.6.2023 dhe merret vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510056-00050-0 në Zonën Kadastrale Optrushë, Komuna e Rahovecit, në sipërfaqe prej 12000m<sup>2</sup> (dymbëdhjetmijë metra katrorë) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 43968m<sup>2</sup> (dyzet e tre mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë metra katror) në vendin e quajtur kamenica – ispod ceste, me kulturë kullosë e klasës 6, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të PASURI E SHTET.E KOSOV.K.K.RAHOVEC SHFRY. EK. E PY. RAHOVEC.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë "Këmbimi i pronës komunale me pronën e institucionit qendror".
3. Autorizohet Kryetari i Komunës që komform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmer të gjitha veprime të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

#### Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Kuvendit,
- Shërbimit të Kuvendit,
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËSNË RAHOVEC

01Nr.95/23  
Datë:27.06.2023

